

Rekomandimet e Raportit të Progresit për vitin 2014 për fushat që i përkasin Ministrisë së Punëve të Brendshme

Lufta kundër korrupsionit

- Shqipëria tashmë duhet të fokusohet në zbatimin e ligjit;
- Nevojiten burime, trajnime dhe staf i specializuar për të përmirësuar efikasitetin e hetimeve dhe për të arritur një vijimësi rezultatesh (*track record*) bindëse në hetime, ndjekje penale dhe dënime në të gjitha nivelet;
- Hetimet e iniciuara kryesisht (hetimet proaktive), vlerësimet sistematike të riskut dhe bashkëpunimi ndërinstytucional duhet të përmirësohen.

Lufta kundër krimit të organizuar

- Krimi i organizuar mbetet një sfidë e konsiderueshme, dhe Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të ndërtuar një vijimësi rezultatesh (*track record*) konsistente në hetime, ndjekje penale dhe dënime në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet;
- Numri i konfiskimeve të pasurive kriminale dhe dënimeve për pastrim parash duhet të rritet përmes përdorimit sistematik të hetimeve financiare;
- Trafikimi i qenieve njerëzore, si ndërkombëtar edhe i brendshëm, mbetet sfidë serioze që kërkon më shumë fokus te qasja holistike e parandalimit, mbrojtjes dhe ndjekjes penale, si edhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Fushatat për çrrënjosjen e cannabis-it dhe lufta kundër trafikut të drogës, që mbetet një shqetësim serioz, duhet të zhvillohen më tej përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përdorimit proaktiv të mjeteve speciale të hetimit dhe vlerësimit të riskut.

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore (për të cilin MPB është institucion kontribues)

Politika antikorruption

- Më shumë punë kërkohet për të rritur efikasitetin e hetimeve dhe për t'i bërë më proaktive, përfshi edhe për hetimet financiare, hetimet për korrupsion të nivelit të lartë, korrupsion në sistemin e drejtësisë, konfliktin e interesit dhe mashtrimin në deklarin e pasurisë;
- Kuadri ligjor aktual duhet të përfshijë dispozita që i mundësojnë Policisë së Shtetit të marrë informacion për qëllime hetimore prej institucioneve publike dhe organeve private që ofrojnë shërbime publike, si edhe që mundësojnë sanksione parandaluese në rast mosrespektimi;
- Kapacitetet hetimore të agjencive ligjzbatuese duhet të forcohen, dhe vlerësimet e riskut duhet të kryhen sistematikisht;
- Nevojiten burime të mjaftueshme, trajnim dhe staf i specializuar për të përmirësuar efikasitetin e hetimeve dhe për të ndërtuar një vijimësi rezultatesh bindëse (*track record*) me hetime, ndjekje penale dhe dënime në të gjitha nivelet;
- Cilësia e statistikave të korrupsionit duhet të përmirësohet;
- Duhet të rriten ndjeshëm kapacitetet në mekanizmat e kontrollit të brendshëm;

- Kontrolli i brendshëm i Ministrisë së Brendshme duhet të forcohet;
- Komunikimi, bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstytucional duhet të përmirësohen, si dhe nevojiten përpjekje për proceset e sanksionimit në rast mosrespektimi të Memorandumeve.

Të drejtat themelore

- Duhet të realizohet një analizë e thelluar e faktorëve që çojnë në emigrimin e fëmijëve të pashoqëruar drejt BE-së.

Përfundim

- Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet antikorruption, të miratojë strategjinë dhe planet antikorruption, të sigurojë zbatimin e kuadrit legjislativ të ndryshuar, si edhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet agjencive ligjzbatuese;
- Gjithashtu, duhet të eliminohen pengesat ndaj hetimeve proaktive dhe efikente për pasuri të pajustificuara dhe korruption, përfshi edhe përdorimin efikas të hetimit financiar, gjë që do të çonte në ndërtimin e një historiku të besueshëm dhe solid rezultatesh (*track record*) me ndjekje penale dhe dënime të formës së prerë në çështjet e korruptionit, kryesisht në nivelet e larta;
- Mbrojtja e grave ndaj të gjitha formave të dhunës ka nevojë për forcim të konsiderueshëm.

Kapitulli 24: Liria, Drejtësia, Siguria

Migrimi:

- Kapacitetet pritëse pranë kufirit duhet të rriten, ashtu si burimet teknike dhe financiare të Policisë së Kufirit dhe Migracionit, me qëllim që të përballohet fluksi në rritje i emigrimit të paligjshëm;
- Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të garantuar zbatim efikas të strategjisë dhe planit të veprimit për emigrantët e kthyer.

Azili

- Sistemi i pritjes së Shqipërisë duhet të forcohet për të përballuar numrin në rritje të azilkërkuesve;
- Procesi i para-skanimit në kufi duhet të forcohet, për të garantuar akses në mbrojtjen ndërkombëtare efikase të azilkërkuesve;
- Procedurat që përcaktojnë statusin e mbrojtjes ndërkombëtare, përfshi aksesin në përfaqësim dhe ndihmë juridike, duhet të përmirësohen më tej.

Politika e Vizave

- Shqipëria duhet të marrë masa të menjëhershme në kuadrin e mekanizimit të monitorimit të post-liberalizimit të vizave, me qëllim që të adresojë abuzimin me azilin, duke përmirësuar

bashkëpunimin operacional dhe shkëmbimin e informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së, si edhe duke kryer hetime të ndërmjetësve të emigracionit të paligjshëm, kontrolle kufitare më efikase, fushata informimi për udhëtarët dhe, mbi të gjitha, duke iu dhënë asistencë të qëndrueshme komuniteteve minoritare.

Kufijtë e jashtëm dhe Shengeni

- Kapaciteti operacional i QNOD-së si dhe qëndrueshmëria financiare dhe teknike e sistemeve të saj të mbikëqyrjes duhet të sigurohen përmes planifikimit të duhur të burimeve buxhetore.

Bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar

- Institucionet ligjzbatuese duhet të përshpejtojnë koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit për të maksimizuar kapacitetet e tyre në hetimin e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar;
- Oficerët e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët vazhdojnë të kenë nevojë për trajnime të vazhdueshme dhe të përbashkëta sipas profileve;
- Shqipëria duhet të zhvillojë dhe të miratojë vlerësime të kërcënimeve strategjike nga krimi i organizuar në territorin e vet, në bashkëpunim të ngushtë me Europol-in;
- Duhet të përmirësohen hetimet proaktive të bazuara në informacion sekret;
- Teknikat speciale të hetimit dhe hetimet financiare nuk zbatohen në mënyrë sistematike;
- Standardet e kontrollit të brendshëm në luftën kundër korrupsionit dhe keqmenaxhimit duhet të përmirësohen;
- Ligji i ri për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme duhet të zbatohet plotësisht dhe duhet të garantohet mbikëqyrje e jashtme dhe e pavarur e punës së policisë;
- Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet policisë dhe prokurorisë gjatë hetimeve;
- Metodrat dhe procedurat e brendshme për mbledhjen e provave dhe përgjimin e telekomunikimeve duhet të përmirësohen;
- Harmonizimi i statistikave të të gjitha institucioneve për historikun e rezultateve (*track record*) të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve duhet të përmirësohet;
- Mbledhja e provave, raportimi dhe përdorimi i teknikave speciale të hetimit duhet të përforcohet;
- Shqipëria duhet të zbatojë marrëveshjen me Europol në mënyrë aktive dhe të intensifikojë shkëmbimin e informacionit.

Pastrimi i Parave

- Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të garantuar interpretimin ligjor korrekt dhe zbatimin efikas të kuadrit ligjor, sidomos në lidhje me ndarjen e veprës penale të pastrimit të parave nga pastrimi i produkteve të veprës penale, si edhe mundësinë e përdorimit të provave indirekte;
- Hetimet kryesisht për rastet e pasurisë së pajustificuar duhet të përshpejtohen;

- Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe aftësitë teknike në fushën e hetimit financiar duhet të forcohen;
- Ende nuk është krijuar një historik rezultatesh (*track record*) për ndjekjen penale të zyrtarëve të lartë.

Trafikimi i Qenieve njerëzore

- Trafikimi i brendshëm mbetet shqetësim dhe hetimet proaktive duhet të konsolidohen më tej;
- Kapacitetet analizuese duhet të përmirësohen, duke marrë në konsideratë kontributet e shoqërisë civile;
- ZKKA duhet të forcohet më tej;
- Trafikimi i qenieve njerëzore edhe nuk po luftohet me një qasje gjithëpërfshirëse, shumë disiplinore dhe të orientuar drejt viktimave; identifikimi i viktimave duhet të përmirësohet;
- Përpjekje të mëtejshme nevojiten për të përmirësuar koordinimin dhe mekanizmin e referimit, si edhe për të garantuar akses të plotë për viktimat sidomos të miturit, në asistencë, mbështetje dhe mbrojtje, përfshirë këtu ri-integrimin e tyre pas kthimit në Shqipëri;
- Shqipëria duhet të transpozojë plotësisht në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale standardet e përcaktuara në Konventën e Palermos dhe në Direktivat e BE-së, me qëllim që të garantojë efikasitetin e hetimeve dhe mbrojtjen e kompensimin e të dhunuarve.

Krimi Kompjuterik

- Oficerët e Policisë dhe Prokurorët duhet të marrin trajnim të specializuar.

Lufta kundër terrorizmit

- Shqipëria duhet të konsolidojë kapacitetet e saj për të parandaluar radikalizmin, përfshi miratimin e masave adekuate për të adresuar fenomenin e luftëtarëve të huaj.

Bashkëpunimi në fushën e drogave

- Duhet të garantohet siguria e magazinimit të drogës dhe procedura efikase të asgjësimit të saj;
- Përpjekje më të vendosura nevojiten për të adresuar këtë problem në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme;
- Puna duhet të intensifikohet dhe vlerësimi i riskut dhe bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të përmirësohen;
- Është thelbësore që të merren masa të mëtejshme për të zhdukur prodhimin e *cannabis*-it në shkallë të gjerë.